




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i faq Broj. stranica Nr. pages	02
Nr Prot Br. Prot Prot. No.	03-02/4318/1
Date Datum Date	29.12.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3731/17, për zyrtarin e lartë z.Behgjet Pacolli, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3731/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z.Behgjet Pacolli, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z.Behgjet Pacolli, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër "DIAMOND FASHION" sh.p.k dhe që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Pacolli, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për rastin që është iniciuar për të .



Lidhur me këtë çështje është organizuar një takim me zyrтарin e lartë z.Behgjet Pacolli, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar për konflikt të mundshëm të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, e që ka të bëjë me funksionin e tij si Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe person i autorizuar në një biznes privatë me emër "DIAMOND FASHION" sh.p.k, po ashtu në këtë takim zyrtarët e AKK-së kanë kërkuar nga ai një sqarim lidhur me pretendimet e mediave kinse z.Pacolli është person i autorizuar edhe në një biznes tjetër me emër "Mabetex Holding" Sh.a (Kosovë).

Zyrtari i lartë z. Bexhet Pacolli, në këtë takim ka deklaruar lidhur me çështjen e ngritur se në biznesin me emër "DIAMOND FASHION" sh.p.k, ka ndërmarr veprimet juridike lidhur me tërheqjen e tij si përfaqësues i autorizuar i kësaj kompanie, për të cilën do të sjell dokumentet zyrtare nga ARBK-ja, ndërsa lidhur me pretendimet e disa mediave se ai figuron si person i autorizuar ne "Mabetex Holding" Sh.a (Kosovë), ai ka deklaruar se nuk është person i autorizuar i këtij biznesi pasi që këtë biznes e udhëheq bordi drejtues, ndërsa ai është vetëm pronar, edhe për këtë do të ofroj dëshmi të lëshuara nga institucioni kompetent që është – ARBK-ja.

Pas këtyre procedurave dhe veprimeve të ndërmarra nga z.Behgjet Pacolli, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z.Behgjet Pacolli, nuk figuron më si person i autorizuar në biznesin privat me emër "DIAMOND FASHION" sh.p.k, po ashtu ka sjell edhe dëshminë tjetër ku shihet se nuk është person i autorizuar ne biznesin "Mabetex Holding" Sh.a (Kosovë) .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari z.Behgjet Pacolli, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke bërë ndryshimet në biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në biznesin privatë, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollari
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

